



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Ex officio

Nr. 235/2018

RAPORT ME REKOMANDIME

I AVOKATIT TË POPULLIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

në lidhje me

Kategorinë e qytetarëve që kanë punuar para vitit 1999 dhe nuk përfitojnë nga pensioni kontributpagues të moshës për shkak se nuk e plotësojnë kriterin e stazhit pensional prej 15 viteve si pasojë e largimit diskriminues nga puna

**Për: Z. Ramush Haradinaj, Kryeministër
Qeveria e Kosovës**

**Z. Skender Reçica, Ministër
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale**

**Z. Bedri Hamza, Ministër
Ministria e Financave**

Prishtinë, më 6 prill 2018

QËLLIMI I RAPORTIT

1. Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes mbi nevojën e rregullimit pozitiv të pensionit kontributpagues për kategorinë qytetarëve të Republikës së Kosovës, të cilët kanë punuar para vitit 1999 dhe nuk e kanë arritur kohën e stazhit pensional prej 15 viteve, pa fajin e tyre, për shkak të largimit diskriminues nga puna në kohën e masave të dhunshme të vendosura në Kosovë.
2. Duke e konsideruar se zgjidhja e kësaj problematike ka një rëndësi të madhe për qytetarët e Republikës dhe njohjen e të drejtave të tyre themelore, Avokati i Popullit ka për qëllim kryesor:
 - të tërheq vëmendjen mbi nevojën e rregullimit ligjor të çështjes se përfitimit të pensionit kontributpagues për qytetarët e Kosovës që kanë punuar para vitit 1999, por që nuk e kanë arritur kriterin e stazhit pensional prej 15 viteve për shkak të largimit nga puna në baza diskriminuuese në vitet e 90-ta;
 - të prezantoj gjendjen faktike në lidhje me rrethanat apo arsyet e largimit nga puna për një pjesë të qytetarëve në kohën e vendosjes së masave të dhunshme në Kosovë, si shkak i mosplotësimit të kriterit për stazh pensional prej 15 viteve;
 - të analizoj legjislacionin që ka qenë në fuqi para vitit 1999, duke bërë një interpretim qëllimor të dispozitës që ka përcaktuar kriterin e stazhit pensional prej 15 viteve. Gjithashtu do të analizohet edhe legjislacioni aktual të Republikës së Kosovës për këtë qëllim.
 - të theksoj parimet themelore të të drejtave të njeriut, sidomos në lidhje me mosdiskriminimin dhe obligimet pozitive që shteti duhet të ketë në raport me qytetarët, që burojnë edhe nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe standardet ndërkombëtare. Në fund, duke vënë në pah këto detyrime, Avokati i Popullit synon të jap edhe rekomandime konkrete në bazë të autorizimeve kushtetuese dhe ligjore të tij.

BAZA KUSHTETUESE DHE LIGJORE

3. Sipas nenit 135, par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: “Kushtetuta”), “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga organete administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore”.
4. Sipas Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16, par. 4, “Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime . . . me iniciativën e vet (exofficio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut”.
5. Gjithashtu, Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 18, par. 1 përcakton se Avokati i Popullit, mes të tjerash, ka edhe këto përgjegjësi:
 - “të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë

mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla” (pika 2);

- “të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit” (pika 5);
- “t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta” (pika 6);
- “të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës” (pika 7);
- “të përgatitë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryejë hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës” (pika 8); dhe
- “t’i rekomandojë Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv” (pika 9).

Me dërgimin e këtij raporti tek institucionet përgjegjëse, Avokati i Popullit synon të kryejë këto përgjegjësi kushtetuese dhe ligjore.

PËRMBLEDHJA E FAKTEVE – ARSYET E HARTIMIT TË RAPORTIT NGA AVOKATI I POPULLIT

6. Avokati i Popullit në kuadër të autorizimeve ligjore dhe kushtetuese të tij, në vazhdimësi ka trajtuar problemet dhe sfidat e pensionistëve në Kosovë, përfshirë edhe kategorinë e pensionistëve kontributpagues që kanë punuar para vitit 1999, por që nuk e kanë arritur stazhin pensional prej 15 viteve.
7. Në lidhje me të drejtat dhe trajtimin e pensionistëve në Kosovë, Avokati i Popullit rithekson se kategoria e qytetarëve që kanë punuar para vitit 1999 dhe nuk e kanë arritur stazhin pensional prej 15 viteve për shkak të largimit nga puna në kohën e vendosjes së masave të dhunshme në Kosovë, paraqesin sfidën kryesore për trajtim nga shteti i Kosovës.
8. Në fakt, e drejta e qytetarëve që bëjnë pjesë në këtë kategori për të përfituar pensionin kontributpagues për periudhën e punës para vitit 1999 (dhe që nuk e kanë arritur kohën e stazhit pensional prej 15 viteve) konsiston në një kolizion midis ligjit që ka përcaktuar kriterin e përfitimit të këtij lloji të pensionit (stazhin pensional prej 15 viteve, siç është edhe përcaktimi në legjislacionin aktual) me parimet që lidhen me të drejtat themelore të njeriut (përkatësisht të drejtën e mbrojtjes së dinjitetit njerëzor, të drejtës për të mos u diskriminuar) dhe obligimet pozitive të shtetit në raport me të drejtat e qytetarëve të tij.
9. Si e tillë, e drejta e përfitimit të pensionit kontributpagues për këtë kategori të qytetarëve të Kosovës është një çështje e veçantë (*suigeneris*) dhe komplekse. Kjo ka të bëjë me

faktin se me ligjin e asaj kohe (para vitit 1999) si kriter për përfitimin e këtij lloji të pensionit është përcaktuar stazhi pensional prej 15 viteve, por për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme, përkatësisht vendosjes së masave të dhunshme në Kosovë, një pjesë e qytetarëve të Kosovës nuk e kanë arritur këtë kriter, pa fajin e tyre, për shkak të largimit diskriminues nga puna. Në anën tjetër, kompleksiteti i kësaj çështje shprehet me nevojën e ndryshimit të legjislacionit në mënyrë afirmative për shkaktë rrethanave të reja jashtëzakonshme, që kanë ndodhur, përkundër kriterit të përcaktuar me ligjin që ka qenë në fuqi në kohën kur këta qytetarë kanë themeluar marrëdhënien punës. Në anën tjetër, edhe legjislacioni aktual i Kosovës, të drejtën e përfitimit të pensionit kontributpagues të moshës e ka rregulluar duke u bazuar në të njëjtin kriter që kanë përcaktuar ligjet e asaj kohe, që të drejtë të përfitimit kanë vetëm punëtorët që kanë arritur stazhin pensional prej 15 viteve.

10. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit rikujton gjithashtu se përveç anës ligjore, kjo çështje për shtetin e Kosovës mund të paraqitet si sfiduese edhe në raport me mundësitë buxhetore për mbulimin e shpenzimeve për dhënien e pensioneve përkategorinë në fjalë.
11. Kjo problematikë është trashëguar nga periudha e para luftës dhe nga rrethanat të cilat janë paraqitur në Kosovë. Siç dihet edhe nga aspekti i legjislacionit, Kosova ka trashëguar ligjet e ish KSAK-së (Ish-Krahina Socialiste Autonome e Kosovës) dhe ligjet federative të ish RSFJ-së, përfshirë edhe fushën e pensioneve.
12. Konkretisht, e drejta për pension kontributpagues para vitit 1999 është rregulluar me Ligjin për Sigurimin Pensional Invalidor nr.011-24/83, Gazeta Zyrtare e KSAK-së nr.26/83 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji Nr.011-24/83 i KSAK) dhe Ligjin federativ të ish RSFJ-së, ku është përcaktuar kriteri i lartpërmendur prej 15 viteve të stazhit pensional për të fituar të drejtën e pensionit kontributpagues. Si të tilla, këto ligje nuk janë konsideruar se kanë karakter diskriminues, dhe sigurisht për kohën kur janë miratuar nuk ka pasur një përmbajtje të tillë.
13. Megjithatë, Avokati i Popullit rithekson se për një kategori të qytetarëve të Kosovës largimi diskriminues nga puna në kohën e masave të dhunshme ka qenë shkak kryesor pse nuk e kanë arritur kohën e stazhit pensional prej 15 viteve. Andaj ky fakt përbën rrethanë të re dhe të jashtëzakonshme përtej dispozitës së ligjit, i cili ka qenë në fuqi dhe ka përcaktuar kriteret e përfitimit të së drejtës për pension kontributpagues.
14. Mbi këtë bazë, Avokati i Popullit vlerëson se e drejta për pensionin kontributpagues për qytetarët e kësaj kategorie duhet të përcaktohet jo vetëm në lidhje me kriterin që ka përcaktuar ligji i asaj kohe (stazhin pensional prej 15 viteve), por edhe duke vlerësuar faktin se largimi nga puna është bërë në mënyrë diskriminuese në kohën e masave të dhunshme.
15. Avokati i Popullit është informuar në vazhdimësi edhe nga ankesat¹ që ka pranuar në lidhje me këtë problematikë dhe raportimet e vazhdueshme në media. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit edhe me herët e ka adresuar këtë çështje të institucionet e Kosovës, në rend të parë në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejshëm: MPMS)

¹Ankesa Ndue Kalaj dhetëtjërëtkundër Qeverisë së Republikës së Kosovës

si dhe në mënyrë të rregullt nëpërmjet raporteve vjetore ka njoftuar edhe Kuvendin e Republikës së Kosovës.

16. Institucioni i Avokatit të Popullit (në tekstin e mëtejshëm: IAP) në vazhdimësi pranon ankesa nga individë dhe shoqata që përfaqësojnë këtë lidhur me kriteret e përcaktuara me Ligjin për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti² për përfitimin e pensionit kontributpagues, me të cilat përcaktohet se përveç arritjes së moshës 65 vjeçare nevojiten edhe 15 vite stazh pensional. Ankuesit konsiderojnë se këto kritere janë kundërshtim me të drejtat dhe liritë themelore të përcaktuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)”.
17. Lidhur me trajtimin e kësaj problematike është bërë një analizë ligjore dhe është zhvilluar një takim me Zyrën Ligjore të MPMS-së nga zyrtarët e IAP-së dhe pas kësaj konstatimi i Avokatit të Popullit ishte se pretendimet e ankuesve nuk janë të qëndrueshme në kuptim të ligjshmërisë, për faktin se ky kriter (15 vite të stazhit pensional) është shprehimisht i përcaktuar në ligj. Ndërsa në raport me KEDNJ, sigurisht për shkak të natyrës së saj konventa nuk e definon të drejtën në pension në kuptim të kriterëve specifikë, të cilat përcaktohen nga legjislacioni i brendshëm i shteteve.
18. Avokati i Popullit ka analizuar këtë problem në drejtim të sqarimit të rrethanave që kanë ndikuar në mos plotësimin e këtij kriteri nga një pjesë e qytetarëve që kanë punuar para vitit 1999. Ky fakt konsiston në largimin nga puna në mënyrë arbitrare dhe diskriminuese në kohën e instalimit të masave të dhunshme në Kosovë në vitet e 90-ta. Mbi këtë bazë, Avokati i Popullit insiston se ky fakt nuk mund të injorohet nga institucionet e Republikës së Kosovës dhe se duhet të gjendet një zgjidhje e arsyeshme ligjore mbi të drejtën e qytetarëve për të përfituar nga pensioni kontributpagues.
19. Janë analizuar disa raste të largimit nga puna në vitet e 90-ta, në kohën e vendosjes së masave të dhunshme, me qëllim të argumentimit se ky proces ka qenë arbitrar dhe diskriminues. Prandaj, ky fakt përbën arsye të mjaftueshme që të ndryshohet Ligji për Pensione dhe kësaj kategorie t’ju njihet e drejta në pension kontributpagues të moshës edhe pse nuk kanë arritur kriterin prej 15 viteve të stazhit pensional.
20. Me qëllim të prezantimit të këtyre rrethanave, në vijim do të prezantohet një nga rastet e analizuar nga Avokati i Popullit në lidhje me mënyrën e largimit nga puna në vitet e 90-ta, në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar dhe shkresave të asaj kohe që janë të disponueshme. Një nga rastet e shumta është edhe i larguari nga puna në kohën e masave të dhunshme me inicialet S.J. që ka punuar në pozitë drejtuese në NN “Mirusha” në Klinë nga viti 1985 deri me datë 17.01.1991, kur i është shkëputur marrëdhënie e punës. Në lidhje me këtë rast të pushimit nga puna në kohën e vendosjes së masave të dhunshme në Kosovë, faktet janë si në vijim:

²Ligji Nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, është miratuar në vitin 2014. Ky ligj rregullon edhe të drejtën në pension kontributpagues të moshës, që ka të bëjë edhe me problematikën e trajtuar në këtë raport.

- Marrëdhënia e punës në NN Mirusha është themeluar me datë 08.05.1985. Për me tepër, S.J. posedon një numër të shkresave në lidhje me krijimin e marrëdhënies së punës dhe vazhdimin e saj në pajtim me ligjet në fuqi dhe aktet e brendshme të ndërmarrjes në fjalë, deri në vendimin për shkëputjen e marrëdhënies së punës. Në këtë drejtim, si dëshmi që janë analizuar nga IAP janë: *libreza e punës që dëshmon për marrëdhënien e punës; Aktvendimi mbi caktimin në vendin e punës në pozitën “Shef i objektit” (25.03.1986); Aktvendimi për caktimin në pozitën “Udhëheqës i prodhimit” (06.03.1987); “Aktvendimi për caktimin e bazës starte për llogaritjen e akontacionit të të ardhurave personale (01.10.1986)”;* *“Aktvendimin për caktimin e bazës fillestare për llogaritjen e akontacionit të të ardhurave personale (24.11.1987)”*, *Polisa e sigurimit*, etj.

21. Në vijim do të paraqitet rrjedha kronologjike e veprimeve deri në vendimin për shkëputjen e marrëdhënies së punës, që del të jenë arbitrare dhe diskriminuese:

- Pas shfrytëzimit të pushimit vjetor nga data 17.09.1990 deri me 19.10.1990 (Vendimi Nr.245/55, dt.13.09.1990), fillon një rrjedh jo e zakonshme e veprimeve deri te vendimi për shkëputjen e marrëdhënies së punës. Kështu me datë 26.11.1990 është marrë një Vendim i Këshillit të Punëtorëve për pushim me pagesë prej 50% nga të ardhurat personale, prej datës 01.12.1990 deri me 01.03.1991 (*vendim të cilin S.J. deklaroi se nuk e ka parë asnjëherë, veç i është kumtuar gojarisht atij dhe disa punëtorëve të tjerë të ndërmarrjes*);
- Pastaj përkundër vendimit të lartpërmendur se do të jenë në pushim deri me datë 01.03.1991, S.J. dhe punëtorët e tjerë kanë marrë ftesë për t’u paraqitur në punë, në zyrën e Drejtorit me datë 09.01.1991, për shkak të kryerjes së detyrave të punës nga neni 72 dhe 75 i Statutit të ndërmarrjes. S.J. deklaroi se: *“me një pjesë të stafit udhëheqës të njërive punuese janë paraqitur në punë dhe kanë kuptuar se në zyrën e drejtorit janë vendosur masat e dhunshme. Nga Sindikata e pavarur është marrë qëndrim që të gjithë punëtorët të hyjnë në biseda me stafin që përfaqësonin sistemin e masave të dhunshme, dhe këtë veprim e kemi ndërmarrë. Për bisedat me stafin e masave të dhunshme ekziston edhe dëshmi Nr.5/91 (e cila nuk është dhënë në dispozicion për punëtorët dhe pastaj me vonë as për avokatin e angazhuar nga grupi i punëtorëve)”*.
- Pas kësaj, S.J. ka pranuar Vendimin Nr.163 të datës 17.01.1991 për shkëputjen e marrëdhënies së punës, i marrë nga **“Organi i përkohshëm punëdrejtues”**, sipas Ligjit mbi Marrëdhëniet e Punës së Serbisë (Fletorja Zyrtare e RSS Nr.40/90). Në këtë vendim ndër të tjera është cekur shprehimisht se marrëdhënia e punës shkëputet pa pëlqimin e punëtorit! Nga kjo vërehet se kemi të bëjmë me një legjislacion që ka ndryshuar në vitin 1990 pas suprimimit të Autonomisë së Kosovës, dhe si rrjedhojë për shkëputje të marrëdhënies së punës nuk është aplikuar legjislacioni i KSAK-së që ka qenë në fuqi në kohën e themelimit të kësaj marrëdhënie.
- Pastaj, S.J. dhe punëtorët e tjerë të larguar nga puna, kanë autorizuar një Avokat i cili ka parashtruar ankesë kundër këtyre vendimeve, por pa sukses për shkak edhe të

mënyrës së funksionimit të sistemit të drejtësisë pas vendosjes së masave të dhunshme dhe kushtevetë krijuara si pasojë e këtyre masave.

22. Nga faktet e prezantuara me lartë, vërehet se praktikrat e largimit nga puna në vitet 90-ta kanë qenë arbitrare dhe diskriminuuese. Kjo arsyeton edhe këtë raport dhe angazhimet e Avokatit të Popullit për zgjidhjen pozitive të këtij problemi.
23. Ky aspekt do të trajtohet edhe përmes një analize ligjore të dispozitave që kanë rregulluar të drejtën e përfitimit nga pensioni kontributpagues dhe legjislacionit aktual të Republikës së Kosovës. Andaj me qëllim të propozimit të një zgjidhje të drejtë për këtë kategori të qytetarëve, në vijim do të analizohet legjislacioni që rregullon këtë fushë dhe parimet kushtetuese që i zbaton Republika e Kosovës, që janë garanci që asnjë qytetarë të mos dëmtohet për shkak të praktikave arbitrare dhe diskriminuuese.

ANALIZA E LEGJISLACIONIT, PRAKTIKA GJYQËSORE DHE OBLIGIMET POZITIVE TË SHTETIT NË RAPORT ME TË DREJTAT E QYTETARËVE

Analiza ligjore

24. Siç është theksuar edhe në këtë raport, aktualisht e drejta në pension kontributpagues në Kosovë është e rregulluar me Ligjin Nr.04/L-131 Për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti (në tekstin e mëtejme: LSPFSh), ku në nenin 4 të tij, përcaktohen 6 skema pensionale, përkatësisht të drejta në pension si: 1) *E drejta në pension bazik të moshës*; 2) *E drejta në pension kontributpagues të moshës*; 3) *E drejta në pension të aftësisë së kufizuar*; 4) *E drejta në pension të parakohshëm*; 5) *E drejta në pension invalidor të punës*; dhe 6) *E drejta në pension familjar*.
25. Nga takimi i realizuar me zyrtarët ligjor të MPMS-së është konfirmuar se ligji zbatohet pjesërisht, në kuptimin e asaj se disa skema pensionale kanë implikime financiare dhe aktualisht është vështirë të zbatohen, mirëpo skema e pensionit kontributpagues të moshës është duke u zbatuar. Kjo skemë fillimisht është zbatuar në mënyrë lineare ku të gjithë përfituesit kanë marrë pagesë të njëjtë, pavarësisht profesionit që e kanë kryer dhe vitet e stazhit pensional. Mirëpo ky aspekt është rregulluar me Udhëzimin Administrativ Nr.09/2015 të datës 31.12.2015 (në tekstin e mëtejme: Udhëzimi Nr.09/2015) për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesës së kontributeve-stazhit pensional, i cili ka bërë kategorizimin e pensionistëve që përfitojnë nga kjo skemë.
26. Kjo skemë vlen për qytetarët e Kosovës të cilët kanë paguar kontributet në ish Fondin Pensional të Kosovës para datës 01.01.1999 sipas dispozitave të Ligjit Nr.011-24/83 të KSAK-së.
27. Kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues të moshës janë të përcaktuara në nenin 8 të LSPFSh ku parashihet se të drejtën në pension kontributpagues të moshës e realizojnë të gjithë personat të cilët kanë shtetësi të Kosovës dhe të cilët:

1.1. kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare;

1.2. duhet të ketë stazh pensionalkontributdhënës, sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999; **(theks i shtuar)**

1.3. ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999.

28. Nga kjo dispozitë, del se ligji aktual në lidhje me kriterin e stazhit pensional për kategorinë e qytetarëve që kanë punuar para vitit 1999 nuk përcakton kohëzgjatje të stazhit pensionalkontributpagues. Ligji aktual i referohet Ligjit Nr.011-24/83 të KSAK-së, i cili në përputhje me ligjin federativ, hollësisht rregullon të drejtat nga sigurimi pensional e invalidor për KSAK, në përputhje me ligjin federativ, përkatësisht Ligjin për të Drejtat Themelore nga Sigurimi Pensional dhe Invalidor (Sl. List SFRJ br, 23/82, 77/82) ku shprehimisht përcaktohen kriteret e tilla (në tekstin e mëtejme: Ligji federativ). Pra është ligji federativ, ai i cili përcakton të drejtat themelore nga sigurimi pensional, e në këtë kuptim përcaktohen edhe kriteret për përfitimin e pensionit kontributpagues ku një ndër to është kohëzgjatja e stazhit pensional.
29. Ligji federativ si akt suprem i zbatueshëm për të gjitha ish-Republikat dhe Krahinat, ka përcaktuar parimet, të drejtat dhe kushtet themelore lidhur me sigurimin pensional dhe invalidor ndërsa Ligji Nr. 011-24/83 i KSAK-së përcakton hollësitë dhe specifikat e sigurimit pensional. Ligji federativ në mënyrë taksative definon kushtet për përfitimin e të drejtës në pension kontributpagues të moshës (Kapitulli III, Pjesa 1, neni 21) si në vijim: “... I siguruari fiton të drejtën e pensionit të pleqërisë kur arrin moshën 65 vjeçare (mashkulli), respektivisht 60 vjet (femra) dhe së paku 15 vite stazh pensional...”.
30. Si i tillë ky kriter për “**stazh pensional prej sëpaku 15 viteve**” është bartur në legjislacionin e Republikës së Kosovës, përkatësisht LSPFSh (neni 8), siç ju referuam me lartë. Pikërisht ky përcaktim, pamundëson që një pjesë e qytetarëve që kanë punuar para vitit 1999 të përfitojnë nga skema e pensionit kontributpagues të moshës, të cilët nuk kanë arritur të kenë stazh pensional prej 15 viteve për shkak të largimit arbitrar dhe diskriminues nga puna, në kohën e vendosjes së masave të dhunshme në Kosovë. Duhet theksuar se të njëjtit kriter i referohet edhe Udhëzimi Administrativ (UA) Nr.11/2007 për Zbatimin e Vendimit të Qeverisë 13/2007, ku në nenin 3 si kriteret për përfitimin e pensionit kontributpagues ka përcaktuar arritjen e moshës 65 vjeçare dhe minimum 15 vjet stazh të sigurimit pensional. Ky udhëzim duket se ka rregulluar këtë fushë deri në hyrjen në fuqi të LSPFSh.
31. Nga kjo që u prezantua me lartë, vërehet se sipas legjislacionit aktual (*ex lege*) qytetarët e Kosovës që kanë punuar para vitit 1999 por që nuk kanë arritur stazhin pensional prej 15 viteve nuk mund të përfitojnë nga pensioni kontributpagues i moshës. Kështu, pa ndryshimin e legjislacionit në fuqi kjo kategori e qytetarëve nuk mund të përfshihen në këtë skemë pensionale, derisa kemi të bëjmë me një kriter ligjor të pavolitshëm për këtë kategori.

32. Këtë përcaktim të nenit 8 të LSPFSh i cili normon kriterin prej 15 vitesh të stazhit pensional siç ka qenë i përcaktuar në Ligjin e KSAK-së, përkatësisht Ligjin federativ, përkundër faktit se ndjek një logjikë harmonike në kuptimin e hartimit të legjislacionit, Avokati i Popullit e konsideron si të padrejtë në raport me punëtorët të cilët janë larguar në mënyrë arbitrare dhe diskriminuese nga puna në vitet e 90-ta, në kohën e masave të dhunshme.
33. Avokati i Popullit vlerëson se për një trajtim jo diskriminues, të drejtë dhe në pajtim me respektimin e dinjitetit njerëzor, shteti i Kosovës duhet të afirmoj të drejtat e qytetarëve që të mos dëmtohen nga praktikat diskriminuese që kanë ndodhur në të kaluarën, siç ka qenë praktika e largimit të dhunshëm nga puna, pa fajin e punëtorëve.
34. Kjo praktikë u prezantua edhe në rastin e analizuar në këtë raport (*Rasti i largimit të S.J. nga puna në fillim të vitit 1991 nga ndërmarrja “NN Mirusha” në Klinë*), ku nga dëshmitë e ofruara nga S.J. del qartësisht se largimi i punëtorëve nga ndërmarrja “NN Mirusha” është bërë në mënyrë arbitrare dhe mbi baza diskriminuese, edhe pse referenca është bërë në ligjet e Serbisë (në rastin konkret në Ligjin mbi marrëdhëniet e punës së Serbisë (Flet.Zyrtare e RSS Nr.40/90) dhe për më tepër vendimi për largim nga puna është marrë nga “*Organi i përkohshëm punëdrejtues*”).
35. Për shkak të natyrës së këtij raporti, Avokati i Popullit ka prezantuar vetëm një rast sa për elaborim të praktikës arbitrare dhe diskriminuese të largimit nga puna në vitet 90-ta, mirëpo e njëjta praktikë është zbatuar edhe ndaj punëtorëve të tjerë të larguar pas suprimimit të Autonomisë së Kosovës dhe vendosjes së masave të dhunshme. Për të kuptuar se kjo praktikë ka qenë diskriminuese dhe e dhunshme, mjafton rikujtimi i “autoritetit të instaluar në atë kohë” që ka marrë vendimet e largimit nga puna, përkatësisht “*Organit të përkohshëm punëdrejtues*” (sic), që përfaqëson vendosjen masave të dhunshme në institucionet dhe ndërmarrjet në Kosovën e viteve 90-ta.
36. Për Avokatin e Popullit, kjo arsye është e mjaftueshme që Institucionet e Republikës së Kosovës (në rend të parë MPMS dhe Qeveria e Republikës së Kosovës) të shmangin diskriminimin e kësaj kategorie të qytetarëve dhe të ndryshojnë LSPFSh, përkatësisht nenin 8 të tij, duke njohur të drejtën për pension kontributpagues të moshës për të gjithë qytetarët që kanë punuar para vitit 1999 por që janë larguar njëanshëm nga puna, mbi bazë të praktikave arbitrare dhe diskriminuese. Kjo do të ishte trajtim i drejtë, që kjo kategori mos të diskriminohet thjesht për shkak të një dispozite që për rrethana normale ka përcaktuar si kriter stazhin pensional prej 15 viteve, por të vlerësohet drejtë edhe rrethana e jashtëzakonshme që janë paraqitur pastaj me vendosjen e masave të dhunshme e diskriminuese në Kosovë.
37. Gjithashtu, Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se nga një interpretim qëllimor i Ligjit Nr. 011-24/83 i KSAK-së dhe dispozitës së Ligjit federativ që përcakton si kriter “*stazhin pensional prej 15 viteve*” del se ky përcaktim është parashikuar për rrethana normale, duke mos parashikuar (natyrshëm) lindjen e rrethanave të jashtëzakonshme që do të mund të pengonin punëtorët në arritjen e këtij kriteri, siç janë paraqitur me vonë masat e dhunshme dhe politika diskriminuese. Andaj edhe pranimi i kësaj dispozite nga ligjvënësi

në Kosovë siç ka ndodhur deri tani edhe me LSPFSh nuk është vlerësim real i rrethanave të jashtëzakonshme që janë paraqitur në vitet e 90-ta.

Praktika gjyqësore dhe aktet normative në raport me procesin e largimit nga puna në kohën e masave të dhunshme në Kosovë

38. Për me tepër, Avokati i Popullit rikujton se largimin nga puna në kohën e masave të dhunshme, si diskriminuese e ka cilësuar edhe Dhoma e Veçantë (me vonë edhe Dhoma e Posaçme, në lidhje me listat e punëtorëve të ndërmarrjeve Shoqërore (NSh) për pjesëmarrje në procesin e privatizimit, Tribunli i Hagës në aktgjykimet e nxjerra, Rezolutat e OKB-së, etj.
39. Siç dihet, në pajtim me Rregulloret e UNMIK-ut mbi të drejtat e punëtorëve të NSh që privatizohen, të drejtë në 20% nga të ardhurat e privatizimit kanë punëtorët të cilët janë të regjistruar si punëtorë të NSh në kohën e privatizimit, për jo më pak se tre vite dhe të cilët duhet të jenë “në listë të punëtorëve”. Krijimi i listës (“lista e punëtorëve”) është paraparë të bëhet në baza jo diskriminuese nga organi përfaqësues i punonjësve në NSh, në bashkëpunim me Federatën e Sindikatave të Pavarura të Kosovës, dhe të paraqitet në ish-Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (tani Agjencia Kosovare e Privatizimit). Punëtorët të cilët nuk janë përfshirë në “listë të punëtorëve” si parakusht për përfitim të beneficioneve kanë pasur të drejtë të paraqesin ankesë në Dhomën e Posaçme, me pretendimin se kanë qenë të diskriminuar, dhe për këtë arsye nuk kanë arritur të përfshihen në “listën legjitime të punëtorëve”.
40. Për me tepër, Dhoma e Posaçme ka ngritur edhe pyetje në lidhje me pajtueshmërinë e Rregullores 2003/13 me dispozitat e veçanta të KEDNJ në kuptim të trajtimit jo diskriminues. Këtë fakt, Avokati i Popullit e thekson me qëllim të rikujtimit se ky standard i referencës në KEDNJ është bërë në kohën kur Kosova nuk ka qenë shtet i pavarur dhe rrjedhimisht nuk ka ekzistuar Kushtetuta që është sot në fuqi, sipas të cilës KEDNJ listohet si instrument drejtpërdrejt i zbatueshëm në Kosovë (neni 22).
41. Nga kjo dispozitë, del se zbatimi i standardeve të përcaktuara në KEDNJ përbën detyrim kushtetues për institucionet e Republikës së Kosovës, dhe se këto duhet të zbatohen edhe në përcaktimin e të drejtave të tjera, konkretisht edhe për të drejtën e përfitimit nga pensioni kontibutpagues. Kjo çështje duhet të vlerësohet në lidhje me bazën diskriminuese të largimit nga puna në kohën e masave të dhunshme.
42. Një aspekt i veçantë në lidhje me normat kundër diskriminimit, ka qenë edhe kërkesa e vitit 2006 e Dhomës së Veçantë për Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm, që të qartësojë nëse Ligji Kundër Diskriminimit i Kosovës i zëvendëson dispozitat për llojin e dëshmimeve të diskriminimit në lidhje me përfshirjen e punëtorëve në lista (Shih *Aktgjykimi në rastin e Ndërmarrjes Progres “Qemajl Peja kundër AKM-së” i datës 17 janar 2006, SCEL-05-0002*). Kjo kërkesë e gjykatës që të drejtat e qytetarëve të respektohen në raport me Ligjin kundër Diskriminimit (tani Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi) e cila përmban garancitë me të larta ndërkombëtare për mbrojtjen kundër diskriminimit, përbën një standard të avancuar. Avokati i Popullit vlerëson se ky standard

duhet të zbatohet edhe në lidhje me të drejtën e pensionistëve kontributpagues që kanë punuar para vitit 1999, në kuptim të ndryshimit të nenit 8 të LSPFSh.

43. Në lidhje me këtë çështje, fakt tjetër interesant sa i përket praktikës së Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme, ka qenë edhe qëndrimi që në lidhje me ankesat e një numri të punëtorëve që supozojnë që janë përjashtuar nga lista e punonjësve për shkak të diskriminimit, të marrën parasysh dhe faktet e tjera me të cilat supozohet se ka pas diskriminim, dhe jo vetëm provat materiale siç kërkohet me nenin 10.6 (b) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/13, duke e cilësuar dispozitën në fjalë si diskriminuese sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut sa i përket nenit 14 të Konventës dhe nenit 8 të Ligjit kundër diskriminimit.
44. Për me tepër, këtë standard me vonë e ka avancuar edhe Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejme: DHPGJS), duke konstatuar se *“Personat që supozohet se i janë nënshtruar diskriminimit janë punëtorët të cilët nuk janë përfshirë në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejta për të përfiturar një pjesë nga 20% e të ardhurave për shkak të përkatësisë së tyre etnike, besimeve politike dhe fetare. Varësisht nga periudha, ata ishin në veçanti: a) punëtorët e përkatësisë etnike shqiptare, ashkali, romë, egjiptian, goran dhe turq, të cilët ishin pushuar për shkaqe diskriminuese në periudhën prej vitit 1989 dhe 1999”*.³
45. DHPGJS me vendimet e saj (ASC-11-0069, AC-I-120012 etj.), gjithashtu ka theksuar se *“... shikuar në aspektin kohor, në lidhje me diskriminimin e pësuar nga kategoritë e lartpërmendura të punëtorëve, duhet të përmendet si vijon: a) Më 26 korrik 1990, qeveria serbe shpalli **“Ligjin e Marrëdhënieve të Punës në Rrethana të Veçanta”** (Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë nr. 40/90), me të cilin, si rezultat, erdhi largimi i mijëra punëtorëve shqiptarë nga vendet e tyre të punës (shih në këtë pikë, edhe Aktgjykimin e TPNJ-së⁴ të datës 30 nëntor 2005 në lëndën nr. IT-03-66, faqe 16, par. 39, që thotë: *Në vitin 1990, Kuvendi i Kosovës dhe Qeveria Krahinore u suprimuan. Në mars 1990, Kuvendi i Serbisë miratoi një sërë masash të cilat çuan në heqjen nga puna të shqiptarëve të Kosovës nga institucionet politike dhe ekonomike dhe nga ndërmarrjet e mëdha ekonomike ...”*.*
46. Mbi këtë bazë, Avokati i Popullit rikujton se Ligji i Marrëdhënieve të Punës në Rrethana të Veçanta” (Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë nr. 40/90) ka qenë diskriminues dhe bazuar në këtë akt të miratuar në kohën e vendosjes së masave të dhunshme është bërë largimi i punëtorëve nga puna, kryesisht të përkatësisë etnike shqiptare. Ky fakt vërehet qartësisht edhe në rastin e prezantuar më sipër (shih pika 19). Gjithashtu, Avokati i Popullit rikujton se ky ligj konsiderohet si diskriminues edhe sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/24.⁵
47. Prandaj, derisa ligji i lartpërmendur ka pas karakter diskriminues, nga një interpretim logjik del se të gjitha pasojat që ka prodhuar ky ligj si i tillë, janë diskriminuese. Duke u

³Aktgjykimi i datës 12 mars 2015 – AC-I.-14-0023.

⁴Tribunali i Hagës për krimet në ish-Jugosllavi.

⁵Rregullorja e UNMIK-ut 1999/24 është miratuar me 12 dhjetor 1999, me qëllim të përcaktimit të ligjit në fuqi në Kosovë.

bazuar në këtë fakt, Avokati i Popullit insiston se ndryshimi i LSPFSh, përkatësisht neni 8 i tij, është i domosdoshëm me qëllim të njohjes së të drejtës për pension kontributpagues të gjithë qytetarëve që kanë punuar para vitit 1999 dhe nuk kanë arritur “stazhin pensional prej 15 viteve” për shkak të largimit nga puna në baza të diskriminimit.

48. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit rikujton edhe referencën e DHPGJS në **Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të KB-së nr. 48/153 të datës 20 dhjetor 1993**, e cila e njeh (dhe dënon) mes të tjerave “... masat dhe praktikatat e diskriminimit dhe shkeljet e të drejtave të njeriut të shqiptarëve të Kosovës, si dhe represionin e madh të bërë nga autoritetet serbe, duke përfshirë: ... b. **Largimin diskriminues të zyrtarëve shqiptarë, veçanërisht nga policia dhe gjyqësori, largimin masiv të shqiptarëve nga pozitat profesionale, administrative dhe pozitat tjera të kualifikuara në ndërmarrjet shoqërore dhe institucionet publike, duke përfshirë mësuesit nga sistemi shkollor i drejtuar nga serbët.**”
49. Për me tepër, ligji diskriminues ka qenë edhe “Ligji mbi Masat e Përkohshme për Mbrojtjen Shoqërore të të Drejtave Vetë-Menaxhuese dhe të Pronës Shoqërore” (Gazeta Zyrtare e RSS nr. 49 të datës 28 tetor 1989) që ka mundësuar që përmes të ashtuquajturave “Masa të Përkohshme” të vendosura në Ndërmarrjet Shoqërore (NSH), menaxhmenti shqiptar është larguar nga puna dhe është zëvendësuar me menaxhmentin serb. Edhe këtë kategori të menaxherëve të larguar e përfaqëson në mënyrë tipike rasti i prezantuar i punëtorit me pozitë drejtuese S.J. Po ashtu, edhe ky ligj konsiderohet i shfuqizuar me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/24 për shkak të karakterit diskriminues.
50. Nga kjo që u trajtua me lartë, del qartësisht se largimi nga puna në kohën e masave të dhunshme ka qenë një proces diskriminues i bazuar në ligje diskriminuese. Mbi këtë bazë, Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se nga këto fakte lind detyrimi kushtetues për Qeverinë e Republikës së Kosovës që të marrë masat për të mënjanuar diskriminimin e kësaj kategorie të qytetarëve duke njohur të drejtën e tyre në pension kontributpagues të moshës për qytetarët që nuk kanë arritur stazhin pensional prej 15 viteve për shkak të largimit të dhunshëm e diskriminues nga puna në vitet e 90-ta.

Detyrimet kushtetuese dhe obligimet pozitive të shtetit të Kosovës në raport me të drejtat e qytetarëve

51. Obligimi i shtetit të Kosovës për të njohur të drejtën në pension kontributpagues për kategorinë e qytetarëve që janë larguar nga puna në baza diskriminuese buron nga një numër i dispozitave të Kushtetutës. Në rend të parë nga dispozitat themelore të Kushtetutës, përkatësisht neni 3 [Barazia para ligjit] ku ndër të tjera përcaktohet se: “Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuarat ndërkombëtarisht ...” (paragrafi 2).
52. Në frymën e kësaj dispozite themelore duhet të miratohet edhe legjislacioni që përcakton të drejtat e caktuara të qytetarëve, përfshirë edhe ligjin që përcakton të drejtën në pension. Në këtë drejtim, derisa është fakt i pakontestueshëm se një pjesë e qytetarëve janë larguar në baza diskriminuese nga puna, në kohën e masave të dhunshme, dhe për këtë shkak nuk

e kanë arritur “*stazhin pensional prej 15 viteve*”, atëherë për një barazi para ligjit kjo kategori nuk mund të barazohet me pjesën tjetër të qytetarëve ndaj të cilëve nuk është zbatuar e njëjta praktikë (ndaj të cilëve, rrjedhimisht edhe mund të zbatohet kriteri për stazh pensional prej 15 viteve). Konkretisht, respektimi i këtij parimi do të nënkuptonte ndryshimin e nenit 8 të LSPFSh, dhe për këtë kategori të qytetarëve të njihet e drejta në pension kontributpagues edhe nëse nuk është arritur kriterin për stazh pensional. Në të kundërtën, Avokati i Popullit vlerëson se dispozita e nenit 8 të LSPFSh, siç është aktualisht, e legjitimon praktikën diskriminuese të largimit nga puna në kohën e masave të dhunshme, dhe në frymën e tij e cenon parimin themelor të barazisë së qytetarëve para ligjit.

53. Ky interpretim gjen mbështetje edhe në kapitullin e II-të të Kushtetutës {**Të Drejtat dhe Liritë Themelore**}, përkatësisht në nenin 24 [Barazia para Ligjit] , paragrafi 3, ku shprehimisht përcaktohet se: “*Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.*” Si e tillë, kjo dispozitë kushtetuese përcakton bazën se për një barazi para ligjit, shteti mund të ndërtojë me masa të veçanta për favorizimin e individëve apo grupeve që nuk janë të barabartë (i ashtuquajtur i diskriminim pozitiv), me qëllim të barazisë me qytetarët e tjerë që nuk janë në pozitë të tillë.
54. Për më tepër, ky standard parashihet edhe si një nga obligimet themelore të shtetit, ku në nenin 58 [Përgjegjësitë e Shtetit], paragrafi 4 i Kushtetutës, parashihet se: “*Republika e Kosovës, sipas nevojës, do të miratojë masa adekuate për të promovuar një barazi të plotë dhe efektive ndërmjet pjesëtarëve të komuniteteve në të gjitha fushat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore. Masat e tilla nuk do të konsiderohen të jenë vepër e diskriminimit*”.
55. Gjithashtu, ndryshimi i LSPFSh (nenit 8) me qëllim që të njihet e drejta në pension kontributpagues të moshës për këtë kategori të qytetarëve që janë diskriminuar në kohën e masave të dhunshme, përkon edhe me vlerat mbi të cilat bazohet Republika e Kosovës, ku përveç tjerash konsistojnë në barazi dhe mosdiskriminim (neni 7 i Kushtetutës).
56. Në lidhje me diskriminimin, në Republikën e Kosovës rëndësi të veçantë ka edhe Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi,⁶ i cili paraqet një kornizë të përgjithshme të parandalimit dhe luftimit të diskriminimit “*në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë...etj, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.*(neni 1, paragrafi1)”.
57. Në raport me mbrojtjen nga diskriminimi, obligimet e shtetit të Kosovës burojnë edhe nga neni 14 i KEDNJ ku përcaktohet se “*Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare*

⁶Ligji Nr. 05/L -021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, me dt.28.05.2015.

ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”. Gjithashtu, garanci për mbrojtje nga diskriminimi parashohin edhe dokumentet e tjera të listuara në nenin 22 të Kushtetutës, si: *Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj; Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor; Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, etj.*

58. Për më tepër, Avokati i Popullit thekson se mohimi i të drejtës në pension kontributpagues të moshës për këtë kategori të qytetarëve përveç se përbën cenim të barazisë para ligjit dhe diskriminim, cenon edhe dinjitetin e tyre, që sipas Kushtetutës duhet të jetë bazë e të gjitha të drejtave të tjera të njeriut. Ky standard përcaktohet në nenin 23 të Kushtetutës ku theksohet se **“Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut”**.
59. Si përfundim, në bazë të fakteve dhe argumenteve të prezantuara në këtë raport, Avokati i Popullit konsideron se Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht MPMS në pajtim me Kushtetutën dhe obligimet pozitive të shtetit në raport me avancimet e të drejtave të njeriut, duhet të iniciojnë ndryshimin e LSPFSh me qëllim që të gjithë qytetarëve që në baza diskriminuese janë larguar nga puna në vitet e 90-ta, të përfitojnë nga pensioni kontributpagues i moshës edhe pse nuk e kanë arritur stazhin pensional prej 15 viteve.
60. Sigurisht, në pajtim me natyrën e të drejtës në pension, MPMS ka autoritetin që të bëjë edhe kategorizimin e pensionisteve që kanë punuar para vitit 1999 në varësi të viteve të punës, profesionit, detyrave dhe kriterëve të tjera për këtë qëllim.
61. Duke u bazuar në gjendjen faktike të rasteve të largimit nga puna në baza diskriminuese në kohën e masave të dhunshme, konstatimet e Gjykatës Supreme dhe mekanizmave ndërkombëtar (Vendimet e Tribunalit të Hagës dhe Rezolutat e OKB-së), Avokati i Popullit konsideron se mund të identifikohen 3 kategori të personave që kanë punuar para vitit 1999 dhe nuk e kanë arritur kriterin për stazh pensional prej 15 viteve:
- a) *Të punësuarit para vitit 1989 që janë larguar nga puna në kohën e vendosjes së masave të dhunshme;*
 - b) *Të punësuarit para vitit 1989 dhe që kanë vazhduar të punojnë deri në vitin 1999; dhe*
 - c) *Të punësuarit pas vitit 1989, pas vendosjes së masave të dhunshme në Kosovë.*
- Ky klasifikim bëhet me qëllim që edhe MPMS, përkatësisht Qeveria e Republikës së Kosovës ta marrë në konsideratë gjatë kategorizimit të personave që mund të përfitojnë nga skema e pensionit kontributpagues të moshës, për punën e kryer para vitit 1999.
62. Për këtë qëllim, pas ndryshimit të LSPFSh dhe njohjes së të drejtës në pension kontributpagues të moshës për këtë kategori të qytetarëve, është e nevojshme edhe ndryshim i **“Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 09/2015 për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues sipas strukturës kualifikuese...”**.

KONSTATIMET DHE REKOMANDIMET E AVOKATIT TË POPULLIT

63. Në këtë raport është trajtuar e drejta në pension kontributpagues të moshës, konkretisht pamundësia e shfrytëzimit të kësaj të drejte nga kategoria e qytetarëve të cilët kanë punuar para vitit 1999, por për shkak të largimit nga puna në kohën e vendosjes së masave të dhunshme në Kosovë, nuk e kanë arritur kohën prej 15 viteve të stazhit pensional (si kriter ligjor për të përfituar nga pensioni kontributpagues i moshës).
64. Avokati i Popullit pas analizës së legjislacionit që ka qenë në fuqi para viteve të 90-ta në lidhje me të drejtën në pension kontributpagues, vëren se ligji (Ligji Nr.011-24/83 i KSAK në lidhje me Ligjin federativ) i asaj kohe si kriter për të përfituar të drejtën në pension kontributpagues, përveç tjerash, ka përcaktuar arritjen e stazhit pensional prej së paku 15 viteve. I njëjti kriter është pranuar edhe me legjislacionin e pasluftës, përfshirë edhe LSPFSh që aktualisht është në fuqi.
65. Bazuar në këtë kriter ligjor, një pjesë e qytetarëve që kanë punuar para vitit 1999 nuk përfitojnë nga pensioni kontributpagues i moshës, për shkak se janë larguar nga punanë kohën e masave të dhunshme dhe nuk e kanë arritur stazhin pensional prej 15 viteve.
66. Nga analiza e fakteve dhe ngjarjeve që ka ndodhur pas vitit 1989, përkatësisht praktikës së largimit nga puna në kohën e masave të dhunshme, Avokati i Popullit konstaton se ky proces ka qenë diskriminues. Nga hulumtimi i IAP del se largimi nga puna në vitet e 90-ta pas vendosjes së masave të dhunshme në Kosovë, është bazuar në praktikë arbitrare, e zbatuar nga “organe të përkohshme” (p.sh. “organi i përkohshëm punëdrejtues” siç është paraqitur edhe në këtë raport) dhe sipas ligjeve të veçanta diskriminuese.
67. Për më tepër, këtë praktikë si diskriminuese e kanë cilësuar edhe Rezolutat e OKB-së, Tribunali i Hagës dhe Gjykata Supreme e Kosovës. Mbi këtë bazë, Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se një praktikë e tillë diskriminuese nuk duhet që edhe më tutje të prodhojë pasoja për qytetarët e Kosovës, përkatësisht kategorinë e qytetarëve që nuk përfitojnë nga pensioni kontributpagues.
68. Për këto arsye, dhe duke u bazuar në detyrimet kushtetuese dhe obligimet pozitive që shteti ka në raport me qytetarët, Avokati i Popullit konstaton domosdoshmërinë që Qeveria e Republikës së Kosovës të marrë masa që të gjithë qytetarët që kanë punuar para vitit 1999 dhe janë larguar nga puna mbi baza diskriminuese të përfitojnë nga pensioni kontributpagues i moshës. Për këtë qëllim është e nevojshme të ndryshohet LSPFSh, përkatësisht neni 8 i tij.

REKOMANDIMET E AVOKATIT TË POPULLIT

69. Në bazë të analizës së bazës ligjore, faktike dhe konstatimeve të arritura, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 18, *parag.1*, nënparagrafët 1.2, 1.4 dhe 1.7 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit rekomandon për institucionet e Republikës së Kosovës, që të ndërmarrin masat e nevojshme me qëllim të garantimit të të drejtës për pension kontributpagues të moshës për qytetarët që kanë punuar para vitit 1999 dhe janë larguar nga puna mbi baza diskriminuese, përkatësisht për:

Qeverinë e Republikës së Kosovës:

1. *Që në kuadër të kompetencave të saj kushtetuese dhe ligjore, të ndërmarrë masat e nevojshme që në afat sa më të shpejtë të fillohet ndryshimi i bazës ligjore dhe të propozoj draft-ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në mënyrë që kategoria e qytetarëve që kanë punuar para vitit 1999 dhe janë larguar nga puna mbi baza diskriminuuese, të përfitojnë nga pensioni kontributpagues. Për këtë qëllim është e nevojshme që të përcaktohen detyrat përkatëse edhe për ministrinë e linjës, në lidhje me përgatitjen e ndryshimeve ligjore dhe planifikimet buxhetore, dhe sipas nevojë të themelohet edhe një grup punues ndërministror.*

Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale:


1. *Që të përgatisë draftin dhe të inicioj ndryshimin e Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti (LSPFSh), përkatësisht nenit 8 të tij, në mënyrë që edhe personat që kanë punuar para vitit 1999 dhe që nuk e kanë arritur stazhin pensional prej 15 viteve për shkak të largimit diskriminues nga puna, t'u njihet e drejta për të përfitur nga pensioni kontributpagues;*
2. *Që të bëjë identifikimin dhe klasifikimin e kësaj kategorie të qytetarëve të Kosovës në bazë të dëshmive relevante;*
3. *Që pas ndryshimit të ligjit të ndryshoj edhe Udhëzimin Administrativ Nr. 09/2015 Për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesës së kontributeve-stazhit pensional*

Ministrinë e Financave

1. *Që të ndërmarrë masat e duhura që përveç mjeteve nga fondi pensional, sipas nevojë të parashikoj mjete financiare shtesë në planin e Buxhetit Shtetëror, me qëllim të dhënies së pensioneve për këtë kategori të qytetarëve. Në kuadër të kompetencave dhe autorizimeve ligjore në afat sa më të shpejtë të propozojë kategorizimin e këtyre pensionistëve në pajtim me kapacitetet që ka buxheti i Republikës së Kosovës.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj") dhe nenin 28 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit ("Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, . . . duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë"), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,


Hilmi Jashari
Avokat i Popullit